




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government



Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit /Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta –Ministry of Culture, Youth & Sports

DIVIZIONI I BURIMEVE NJERËZORE / DIVISION OF HUMAN RESOURCES / DIVIZIJA LJUDSKIH IZVORA

Bazuar në Ligjin Nr. 06/L – 114 për Zyrtarët Publik, Neni 38 (1,2,3 dhe 4), Ligjin Nr. 08/L-196, për Pagat në Sektorin Publik, Rregulloren (QRK) NR. 16/2020, për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregulloren (QRK) Nr. 10/2022, për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit shpall:

KONKURS

Të drejtë për aplikim në këtë procedurë kanë vetëm nëpunësit civil ekzistues të së njëjtës kategori të punësuar në të njëjtin apo në një tjetër institucion të shërbimit civil.

Titulli i pozitës së punës: Udhëheqës i Divizionit për Menaxhim të Integruar dhe Turizëm Kulturor

Kategoria funksionale: Drejtues i ulët

Klasa e pozitës: I9

Koeficienti: 7.4

Nr. i kërkuar: 1

Data e njoftimit: 31.08.2023

Afati për aplikim: 8 ditë

Institucioni: Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Departamenti: Departamenti i Trashëgimisë Kulturore

Divizioni: Divizioni për Menaxhim të Integruar dhe Turizëm Kulturor

Faqe 1 nga 9

Nr. i Referencës: RN00012440

Kodi: RPC0005999

Përshkrimi i përgjithshëm i punës

1. Mbështet dhe ofron këshilla për drejtorin e Departamentit dhe sipas kërkesës për udhëheqësin më të lartë administrativ të institucionit dhe titullarin e institucionit për fushën e përgjegjësisë së Divizionit që udhëheqë;
2. Drejton dhe mbikëqyrë të gjitha aktivitetet e Divizionit për Menaxhim të Integruar dhe Turizëm Kulturor dhe siguron funksionim efikas të tij, si dhe ndihmon Drejtorin në caktimin e objektivave dhe zhvillimin e planit të punës për përmbushjen e këtyre objektivave;
3. Kontribuon në procesin e vendimmarrjes sipas fushës së përgjegjësisë, duke siguruar të dhëna të detajuara dhe analizave të cilat mbështesin procesin e vendimmarrjes;
4. Planifikon, përgatit, monitoron dhe analizon buxhetin e Divizionit si dhe aktivitetet tjera të Divizionit dhe siguron përmbushjen e tyre sipas planit;
5. Organizon dhe shpërndan punën për stafin të tij dhe menaxhon realizimin e detyrave dhe përgjegjësisë që duhen përmbushur në përputhje me objektivat dhe përgjegjësitë e Divizionit;
6. Udhëzon stafin në përmbushjen e aktiviteteve të përditshme dhe siguron që kjo veprimtari të jetë në përputhje me legjislacionin, politikat institucionale dhe standardet përkatëse;
7. Me autorizimin e mbikëqyrësit, përfaqëson institucionin në takime pune, konferenca në fushën e përgjegjësive të Divizionit të cilin e udhëheqë;
8. Siguron komunikimin brenda dhe jashtë njësisë organizative dhe institucionit me qëllim të mbledhjes ose shkëmbimit të informacionit;
9. Bën vlerësimin e rezultateve të punës për stafin nën mbikëqyrje të tij dhe identifikon nevojat për ngritjen e kapaciteteve të tyre.

Kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta

- Të jetë nëpunës civilë i të njëjtës kategori për të cilin aplikon.
- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar në detyrë në rastin e lëvizjes brenda kategorisë profesionale.

Faqe 2 nga 9

- Të mos jetë ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende.
- Të jetë vlerësuar të paktën 'mire' për rezultatet në punë, të paktën gjatë dy viteve të fundit të vlerësimit.
- Në rastin e konkurimit për levizje brenda kategorisë profesionale të jetë vlerësuar të paktën mirë në vitin e fundit.

Kërkesat e përgjithshme formale

a) Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 3 vite të studimeve.

b) Kualifikime të posaçme formale: Certifikata, licenca kur kërkohen me legjislacionin në fuqi apo kur vlerësohet se janë të nevojshme për pozitën e kësaj klase.

c) Përvoja e punës e kërkuar: Së paku tri (3) vite përvojë pune profesionale.

Kërkesat (Njohuritë, aftësitë dhe cilësitë) e përgjithshme të nevojshme:

- Njohuri të gjëra e të thella të politikave, legjislacionit, procedurave sipas veprimtarisë që mbulon Divizioni.
- Aftësi organizative dhe drejtuese për të menaxhuar njësi organizative.
- Aftësi për t'iu përshtatur prioriteteve dhe kërkesave, afateve kohore përmes aftësive analitike dhe zgjidhjes së problemeve.
- Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësinë për të krijuar dhe mbajtur marrëdhënie besimi me eprorin dhe stafin që e menaxhon.
- Aftësi për të motivuar stafin dhe për të menaxhuar me sukses Projektet e Divizionit.

Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim

Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore;

Kopjet e dëshmive së punësimit;

Kopjet e dëshmive të trajnimeve;

Data e daljes së rezultateve të vlerësimit paraprak

- Lista e kandidatëve të cilët plotësojnë kushtet për lëvizje brenda kategorisë do të shpallet më së largu deri më datën , në portalin e rekrutimit elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>).

Data, vendi dhe ora ku do të zhvillohet intervista me gojë
Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit

Fusha e njohurive, aftësive dhe cilësive që do të vlerësohen në intervistën me gojë

- Aftësi organizative dhe drejtuese për të menaxhuar njësi organizative;
- Aftësi për t'iu përshtatur prioriteteve dhe kërkesave, afateve kohore përmes aftësive analitike dhe zgjidhjes së problemeve;
- Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësinë për të krijuar dhe mbajtur marrëdhënie besimi me eprorin dhe stafin që e menaxhon;
- Aftësi për të motivuar stafin dhe për të menaxhuar me sukses Projektet e Divizionit.

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

- Intervista

Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

- Përmes email dhe portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

Mënyra e aplikimit

- Përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

Data e shpalljes së rezultateve përfundimtare

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

Data e njoftimit në Web faqen unike të procedurave të konkurimit <https://konkursi.rks-gov.net> është prej dt. 31.08.2023 deri me dt. 14.09.2023, ndërsa data e aplikimit është nga data 15.09.2023 deri me datën 22.09.2023.

Përveç Web faqes unike të procedurave të konkurimit, konkursi publikohet edhe në Web faqen e MKRS-së.

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ofron mundësi të barabarta punësimi për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil e administratës publike qendrore dhe lokale.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.